

V E N D I M
Nr. 304, datë 27.6.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.311, DATË 11.7.1994 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRFITIMIN E PAAFTËSISË", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.311, datë 11.7.1994 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.457, datë 21.8.1995 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Pagesa e përfitimit të paaftësisë është 6 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.".

2. Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Masa e përfitimit të kujdestarisë është 5 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.".

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002 për pagesën e paaftësisë, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko